



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



12 Nr 360/01-65512 dt. 23.12 2021

Bazuar në nenin 11,12,dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34,pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, nenit 3 pika 1.1 , nenit 9 Ligjit Nr. 03/L-164, për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, nenit 2, nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Vendimit të Qeverisë Nr. 02/46, të dt. 30.11.2021, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19,Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë, 23.12. 2021,miratoi këtë:

V E N D I M

Për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfutuese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2022.

Neni 1

Me këtë vendim, kërkohet lirimi i familjeve përfutuese të shfrytëzimit të përkohshëm social në Bllokun I dhe II në Komunën e Drenasit nga obligimi i pagesës së qirasë joprofitabile për vitin 2022.

Neni 2

Familjet e liruar nga qiraja joprofitabile për vitin fiskal 2022 janë të përcaktuara/përfshira në Vendimet e Kuvendit Komunal 12. Nr. 360-68569 të datës 29.11.2019, Vendimit 12Nr. 360/02-9351, të dt. 26.02.2021, si dhe Vendimin Nr. 12-360/01-28743, mbi lidhjen e Kontratave për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të banesave në Banimin e Përkohshëm Social, në Bllokun I dhe II në Drenasin III.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPLsi dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Alaim Hajdari
Alaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MIEDIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org./Instituc. Org./Unit	Nr./Prot. Broj/Prot. Prot. No.
Nr./Faqeje Br./Stranica No./Pages	Data: Datum: Date:
32-09.	5886-2/21
- 02 -	10.03.22
PRISHTINË / A	No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Trim Berisha, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPHI
Zyrtarët përgjegjës:	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lloji i aktit:	Vendimi 12 Nr.360/01-65512, për lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet e perfituese të shfrytëzimit të perkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2022, miratuar nga KK Glllogoc.

I nderuar Kryetar/e Lladrovci,
I nderuar Kryesues/e Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI) ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin 12 Nr.360/01-65512, për lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet e perfituese të shfrytëzimit të perkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2022, miratuar nga KK Glllogoc.
I miratuar me datë: 23.12.2021
I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 23.12.2021
I dërguar për shqyrtim në MMPHI, me datë: 28.12.2021

Ministria e Mjedist, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson: Në nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, parashihet "Kuvendi Komunal çdo vit aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira..." ndërsa në Nenin 10 paragrafi 1 të të njëjtit ligj thuhet: " Për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë, shteti subvencionon deri në pesëdhjetë për qind (50%) të shumës së qirasë që duhet ta paguajë familja. Subvencionimi jepet vetëm pas verifikimit të gjendjes ekonomike të familjes, sipas nenit 12, të këtij ligji".

Neni 12 paragrafi 1 përcakton: " Përfitimi nga programet e banimit bazohet në verifikimin e gjendjes ekonomike të familjes". Kjo çështje, po ashtu rregullohet edhe dispozitat e nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr 18/2010 për përmbajtjen e Kontratës për banesën me qira joprofitabile.

Ministria e Mjedist, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, konstatoi se vendimi 12 Nr.360/01-65512, për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet e perfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenas për vitin 2022, miratuar nga KK Glogoc, është bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.02/46, datë 30.11.2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, andaj, si e tillë Kuvendi Komunal i Glogocit, duhet të marrë përgjegjësi për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II, në Drenasin III për vitin 2022.

MMPHI, mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.